
AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"IS-ENERGY" SHPK

1. Forma ligjore, emri i shoqërisë dhe ortakut themelues

Emri i shoqërisë do të jetë **"IS-ENERGY" SHPK**, nga këtu e më poshtë referuar edhe si "shoqëria", e cila themelohet si një shoqëri tregtare në formën e "Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "SHPK".

Shoqëria zotërohet nga ortakut i vetëm:

- **Shoqëria "VEKO" SHPK**, regjistruar në regjistrin tregtar me NUIS K12511628P, me seli në Vrisera, Gjirokastrë, Shqipëri

2. Objekti i veprimtarisë.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:

- Tregeti e përgjithshme, import eksport. Shitje e blerje, dhenie apo marrje me qira të pasurive të paluajtshme dhe veprime të tjera me to. Studimin, Projektimin dhe Ndertimin e impianteve të energjisë së rinovueshme dhe Impianteve të tjera të Prodhimit të energjisë. Implementimi dhe menaxhimi i projektit gjenerues të energjisë elektrike, fotovoltaike, eolike etj dhe veprave ndihmëse për funksionimin e tyre. Prodhimi i energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme. Kryerje e aktivitetit të import, eksport, tregtim dhe furnizim me shumicë dhe pakicë të energjisë elektrike si brenda dhe jashtë Shqipërisë. Transmetimi i energjisë elektrike në sistemin e tensionit të lartë, funksion i cili përfshin transmetimin ose interkonjeksionin ndërkombëtar. Përdorimin e sistemeve të linjave, strukturave mbështetëse dhe pajisjesh transformuese për transmetimin e energjisë elektrike. Shpërndarjen, transportin e energjisë elektrike në sistemet shpërndarëse të tensionit të mesëm dhe të ulët, duke patur parasysh shpërndarjen deri tek konsumatori i fundit.

Në funksion të sa më sipër, shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet të lejuar dhe në përputhje me legjisllacionin në fuqi.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.



3. Selia e shoqërisë.

Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: **Tirane, Kashar, Rruga Industriale, Autostrada Tirane-Durres, Km 1, Godina Veko Shpk, Kati 6.**

Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.

4. Kohëzgjatja e shoqërisë.

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është **i pacaktuar**. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

5. Kapitali themeltar.

Kapitali themeltar i shoqërisë është **500.000** (peseqind mije) lekë.

Kapitali përbëhet nga 1 (një) kuotë me vlerë nominale **500.000** (peseqind mije) lekë dhe zotërohen nga ortaku i vetëm i shoqërisë.

6. Organet vendimmarrëse të shoqërisë.

Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve.
- Administratori.

7. Administratori.

Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Ai zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Mandati është i rinovueshëm. Administratori i shoqërisë është:

- **Z.Dhimosten Koca**, atësia Vangjel, amësia Evdhoksia, shtetas Shqiptar, lindur më 04/10/1973, në Gjirokaster dhe banues në Dropull, me adresë: Vodhine, Gjirokaster, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftim ID Nr. 036389749 dhe Nr. Personal H31004026C.

8. Likuidimi i shoqërisë.




Në rast prishje të shoqërisë, likuidimi apo falimentimi, shoqëria do të likuidohet në përputhje me dispozitat në fuqi në legjislacionin shqiptar.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË

Shoqëria VEKO SHPK

Përfaqësuar nga



[emër mbiemër dhe nënshkrimi]



Data 06 / 03 / 2025